

NJOFTIMI I MODIFIKIMIT TË **KONTRATËS GJATË KOHËZGJATJES SË** **SAJ**

BASHKIA POGRADEC

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E KONTRATËS GJATË ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Bashkia Pogradec
Adresa Lagjja nr 2, bulevardi "Reshit Çollaku"
Tel/Fax 083222222
E-mail bashkiapogradec@gmail.com
Faqjanë Internet www.app.gov.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri: Brunildo Çekiçi
E-mail: Brunildocekici27@yahoo.com

3. Lloji i procedurës së prokurimit: "Procedure e Hapur – Pune - Elektronike"

4. Lloji i kontratës /Marreveshjes kuader: Kontratë me Çmim Njësie të bazuar në çmimet e njësisë të shprehura në Preventivin në Njësi.

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-25463-10-18-2024

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: "Rikonstruksion kanali ujites rezervuari i Pusic-Gjolllet, Leshnice".

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

Punime ndertimi per diga, kanale, kanale te ujitjes dhe ujesjelles 45247000-0; Punime ndertimi per diga 45247210-2; Punime ndertimi per rezervuare 45247270-3

8. Fondi limit: 11 941 854, 68 (njëmbëdhjetë milion e nentëqind e dyzet e një mijë e teteqind e pesëdhjetë e katër presje gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë: Referuar pikës 1 germa c, të nenit 127 "Modifikimi i kontratave gjatë afatit të tyre", të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" te ndryshuar, citohet se:

c) "Kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër". Në bazë të kontratës publike Nr. 4324/6 Prot, Datë 11.12.2024, për objektin: "Rikonstruksion kanali ujites rezervuari i Pusic-Gjolllet, Leshnice", Njoftimit të fillimit të punimeve të datës 11.12.2024, e cila parashikonte si afat të punimeve periudhën prej 2 muaj nga marrja në dorëzim e sheshit të ndërtimit si dhe bazuar ne shkresën me Nr. 422 Prot, datë 27.01.2025 me lëndë: "Njoftim pezullim

punimesh në objektin “Rikonstrukcion kanali ujitës rezervuari i Pusi-Gjollës, Leshnicë” nga sipermarrësi (BOE): “INFINIT” shpk dhe “L.T.E CONSTRUCTION” shpk, miratuar me shkresën nga mbikqyrësi i punimeve OE “NOVATECH” shpk, për shkak se gjatë zbatimit të punimeve në objekt janë ndërprerë punimet si pasojë e përkeqësimit të kushteve të motit (reshje bore dhe shira të rrëmbyeshëm, temperatura të ulta etj.) si dhe problemeve sociale të dala gjatë zbatimit me pronarët pretendues të sipërfaqeve pranë kanalit, duke u bërë pengesë për të përfunduar punimet sipas kontratës.

Gjithashtu mbështetur në pikën 3, të nenit 27 të kontratës së punimeve, të lidhur midis “Bashkisë Pogradec” dhe (BOE): “INFINIT” shpk dhe “L.T.E CONSTRUCTION” shpk, i cili parashikon se: Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Kontraktori ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë realizimin në kohë të punimeve objekt kontrate në përputhje me Nenin 5, Kontraktori njofton menjëherë Autoritetin/Entin Kontraktormë shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Kontraktorit, Autoritetin/Entin Kontraktor vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Kontraktorit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.

Kërkesa e mësipërme, pasi u miratua nga Mbikqyrësi i punimeve, u mor në shqyrtim nga Grupi i Monitorimit të Kontratës prane Autoritetit Kontraktor, i cili miratoi kërkesën e paraqitur nga mbikqyrësi, si më poshtë:

- 1- Gjatë zhvillimit të punimeve janë hasur vështirësi nga kontraktori, në ecjen e punës me ritme të mira, për shkak të kushteve të këqija atmosferike (reshje bore dhe shira të rrëmbyeshëm, temperatura të ulta etj) si dhe është hasur vështirësi në lirin e sheshit si pasojë e pretendimeve nga banorët për sipërfaqet e zaptuara pranë kanalit ujitës që po ndërtohet.

Duke qenë se, ekzistonin kushtet paraprake, të cilat përbëjnë pjesën integrale të kësaj kontrate, sa më sipër bazuar, në njoftimet dhe korrespondencën e mbajtur deri më tani, si dhe pas zgjidhjes së problemit të banorëve, për pronën e tyre pranë kanalit ujitës me Akt-verifikimin e mbajtur më datë 04.08.2025 midis Bashkisë Pogradec, qytetarit dhe Kontraktuesit dhe shkresës së Mbikqyresit të punimeve “NOVATECH” shpk me nr. 93 prot. Datë 04.08.2025, protokolluar prane Bashkisë Pogradec me nr. 422/1 prot, date 04.08.2025, me lëndë: “Njoftim për rifillim punimesh në objektin” Rikonstrukcion kanali ujitës rezervuari i Pusi- Gjollës, Leshnicë”.

Palët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, ranë dakort për hartimin dhe nënshkrimin e amendamentit “Për Shtyje Afati në objekt”, për sa më poshtë:

-Për shkak se punimet në objekt janë pezulluar, duke mbetur edhe 15 ditë të papunuara aplikohet shtyrje e afatit të kontratës nga data 05.08.2025 deri në datën 20.08.2025.

-Kushtet e tjera të kontratës mbeten të pandryshuara.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e punimeve

Modifikimi i afatit të kontratës duke mos ndryshuar në thelb kontratën, vlerën dhe sasinë, por vetëm afatin e përfundimit të kontratës.

11.Vlera totale e kontratës së nënshkruar:

8 075 300 (tetë milion e shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind) lekë pa TVSH ose 9 690 360 (nëntë milion e gjashtëqind e nentëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) Lekë me TVSH.

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): Nuk ndryshon Vlera

13. Kohëzgjatja e kontratës: 2 muaj nga data e marrjes në dorëzim të sheshit të ndërtimit, (domethene 2 muaj nga data 11.12.2024, date e cila korespondon me Njoftimin e fillimit të punimeve)

Dhe afati i ri (nëse është rasti): 15 ditë te papunuara (domethene aplikohet shtyrje e afatit të kontratës nga nënshkrimi i amendamentit me date 05.08.2025 deri në datën 20.08.2025.)

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomik:

Emri (BOE): “INFINIT” shpk meadadministrator z. Kujtim Bregu dhe
“L.T.E CONSTRUCTION” shpk, me administrator z. Artur Caushaj.
Adresa: “INFINIT” shpk me adresë: Korce , Pogradec ,Rruga Fan Noli, lagjja 3, nr pasurie
3/167 dhe “L.T.E CONSTRUCTION” shpk, me Nipt L78006801F, me adrese:
Tirane, Kashar, Rruga 3 Deshmoret, Kompleksi Grand, Apartamenti F-2-08, Kati 1

Numri i NIPT-it: “INFINIT” shpk me Nipt J74304623M dhe
“L.T.E CONSTRUCTION” shpk, me Nipt L78006801F

15. Data e nënshkrimit të modifikimit: 05.08.2025

16. Burimi i financimit: Te ardhurat - Vetëfinancim

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor: _____